



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ALFA I" për aktivitetin: "Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rruges Muharrem Fejza" me Nr. të Prok: 616 19 6284 511 dhe numer të brendshëm 616 19 145 511 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "ALFA I" e datës 15.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rruges Muharrem Fejza" me Nr. të Prok: : 616 19 145 511 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 10.12.2020 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 10.12.2020 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "ALFA I" me datë 15.12.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' " Implementimi i planit të mobilitetit-rekonstruim i rruges Muharrem Fejza" me Nr. të Prok: 616 19 145 511 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e OE-ik "Alfa I" janë tërësisht të pa bazuara, pasi që i njëjti pretendimet e veta i bazon në një Vendim të mëparme të OSHP-se e jo në Vendimin e fundit numër 647/20. Nëse analizojmë Vendimet paraprake ia rikujtoj pretenduesit se në një rast i njëjti është trajtuar i pa përgjegjshëm, por në Vendimin vijues ka ardhur rekomandimi që AK-ja të kërkojë sqarime, edhe pse sipas të gjitha rregullave juridike rasti ka qenë rast i gjykuar dhe është dashtë të respektohet si i tillë. Njësoj ka ndodhur në Vendimet e mëparme (në Vendimin që edhe pretenduesi e bazon kërkesën e vet) lidhur me tenderuesin e rekomanduar për dhenje të kontratës "Rahovica Commerce SHPK", mirëpo prap i njëjti Organ (OSHP-ja) ka dhënë Vendim tjetër ku të njëjtin e trajton si të përgjegjshëm, ndërsa tenderin e pretenduesit si të pa përgjegjshëm (Vendimi numër 647/20). Lidhur me këto ju sqaroj se Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë që të analizojë e që me pak të ndryshojë rekomandimet e OSHP-se, por përkundrazi e ka për obligim të respektojë dhe të zbatojë të njëjtat. Duke respektuar të njëjtat Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhenje të kontratës OE-ik "Rahovica Commerce SHPK" dhe ka refuzuar tenderin tuaj. Refuzimi i tenderit tuaj është bërë në bazë të konstatimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-se dhënë në faqen 12 të Vendimit ku në mënyrë decisive është cekur se OE-ik "Alfa I" nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, respektivisht citojmë:"

Lidhur me pretendimin e OE: "Rahovica Commerce" s.h.p.k. se sipas kërkesës në DT ka qenë të paraqiten dy teknik të ndërtimitarisë ndërsa OE "ALFA. I" i rekomanduar me kontratë në ofertën e tij ka angazhuar personel profesional: z. Bekim Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie - profili arsimor - Murator (fasader) të shkallës së III-<sup>te</sup> të përgatitjes profesionale dhe z. Muhamet Demaj me përgatitje shkollore - Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie - profili arsimor - Murator - Fasader të shkallës së III-<sup>te</sup> të përgatitjes profesionale, **Paneli shqyrtues konform** Ekspertit shqyrtues konstaton se OE "ALFA. I" në dokumentacionin e dorëzuar me ofertë dhe kërkesave të kërkuar me FTD në dosjen e tenderit të kriteret e kërkuara pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, ku kërkohet që Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të më poshtme: - 2 Teknikë të Ndërtimitarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Andaj konstatojmë se kjo pikë e ankese është e qëndrueshme sepse OE "ALFA. I" në dokumentacionin e ofruar me ofertë për 2 Teknik të Ndërtimitarisë ka ofruar dokumentacionin të stafit me përgatitje shkollore - **"Shkollë të Mesme Teknike - Ndërtimtarie - profili arsimor - Murator- fasader të shkallës së III-<sup>te</sup> të përgatitjes profesionale"**, ndërsa përgatitja profesionale është kërkuar për këtë personel profesional **Shkollë e mesme teknike profili arsimor - Teknik i ndërtimitarisë të shkallës së IV-<sup>te</sup> të përgatitjes profesionale**. Andaj OE "ALFA. I" me ofertën e tij nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pra nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara sipas FTD në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë siç është kërkuar pasi që ky kriter ka mundur që të ndikojë që shumë operator ekonomik të mos dorëzojnë ofertën e tyre sepse në stafin e tyre nuk kanë pasur me profil - **Teknik të Ndërtimitarisë** dhe nuk kanë menduar se me kuadër tjetër mundën me e plotësuar këtë kriter të kërkuar në pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional me

Bazuar në konstatimin e Panelit Shqyrtues dhe sqarimet paraprake pretendimet tuaja janë të pa bazuara.

**Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.**

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.**

**Këshilla juridike:**

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit